



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 81/17
Prishtinë, më 09.03.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje e Komisionit për Buxhet dhe Financa morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadërgjonaj, Shukri Buja, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Shqipe Pantina, Sali Morina, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Munguan: Jelena Bontić, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të tjerë: Ismet Krasniqi-Sekretar i Kuvendit, Emrush Haxhiu dhe Istret Azemi nga Administrata e Kuvendit.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit - Naser Osmani.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datën 28.02.2017;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe amendamenteve të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
4. Shqyrtimi i Amendamentit Plotësues të Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike për Projektligjin Nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave;
5. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-127 për plotësimin e Ligjit Nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Besa Gaxherri - kërkoi që në mbledhjen e radhës së Komisionit të futet si pikë e rendit të ditës çështja e incidentit gjatë kthimit të Komisionit nga vizita në Shqipëri.

Kryetari- konstatoi se rendi i dites miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datë 28.02.2017

Kryetari - konstatoi se procesverbali nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, më datë 28.02.2017 miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr.05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Kryetari – theksoi se projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji Nr.05/L-129 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe amendamenteve të Komisionit Funkcional për Legjislacion, Madate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Amendamentit Plotësues të Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike për Projektligjin Nr.05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave

Kryetari – komisioni funksional me raportin plotësues ka riformuluar nenin 23 që ka të bëjë me rregullimin e pagave të auditorëve të brendshëm. Në amendamentin që kemi bërë në raportin e parë, kemi propozuar që auditorët dhe stafi të trajtohen si shërbyes civil në paga, pasi që e kanë edhe të tillë statusin e punës. Ndërkaq, komisioni funksional me amendamentin plotësues ka riformuluar nenin 23 dhe ka propozuar që auditorët e brendshëm dhe stafi i NJQH-së, të paguhen sikurse auditorët e jashtëm.

Safete Hadërgjonaj - theksoi se nuk është mirë që në ligj të shkruhet qështja e harmonizimit të pagave. Nuk jam që me pas kufizime të pagave të auditorëve të brendshëm dhe stafit të NJQH-së. Por me rastin e miratimit të ligjit për pagat duhet pasur kujdes, që të rangohen në përputhje me statusin dhe përgjegjësitë që kanë auditorët e brendshëm dhe stafi NJQH-së.

Shukri Buja – theksoi se në bazë të përvojës në të kaluarën si kryetar komune, edhe pse nuk ka qenë e specifikuar me ligj, me rekomandimin e Auditorit Gjeneral ne i kemi rritur pagat e auditorëve të brendshëm dhe tre prej tyre i kanë pasur pagat më të larta se të drejtorave të drejtorive komunale. Ndërsa, paga e udhëheqësit të Njesisë së auditimit të brendshëm ka qenë barabartë me pagën e kryetarit të komunes apo diku afro 70 euro e dallueshme.

Kryetari – në bazë edhe të diskutimeve, propozojë që si komision të rekomandojmë se mbesim pranë amendamentit të propozuara me raportin me rekomandime të datës 14.02.2017.

Pas përfundimit të diskutimeve dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

Rekomandim

Komisioni për Buxhet dhe Financa, rekomandon që amendamenti plotësues i Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, që ka të bëjë me nenin 23 të Projektligjit nr. 05/L-122 për Kontrollin e Brendshëm të Financave, të hiqet dhe të mbetet amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe Financa për plotësimin e nenit 23, i propozuar në Raportin me rekomandime të datës 14.2.2017.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari – theksoi se projektligji nuk përmbanë implikime buxhetore shtesë. Ndërkaq, komisioni funksional nuk ka propozuar amendamente.

Pas përfundimit të diskutimit dhe në bazë të propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht nxori këtë

Rekomandim

Projektligji nr.05/L-127 për plotësimin e Ligjit nr.04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Të ndryshme

Kryetari- njoftoi se në mbledhje është i pranishëm Sekretari i Kuvendit i cili ka shprehur kërkesën për të folur lidhur me KASH-in e Kuvendit 2018-2020.

Ismet Krasniqi – njoftoi anëtarët se kanë marrë instrukcionet nga Ministria e Financave për hartimin e KASH-it 2018-2020 dhe sikurse viteve të kaluara kërkojë nga Komisioni që të catojë një grup punues që bashkarisht me Administratën e Kuvendit të pergadisnin KASH-in e Kuvendit.

Kryetari - propozoi që komisioni të themelojë grupin punues për përgaditjen e KASH-it të Kuvendit të Kosovës 2018-2020, në bashkëpunim me Administratën, me këtë përberje: Fikrim Damka-kryesues, Sali Morina dhe Labinota Demi-Murtezi.

Në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni unanimitisht, nxori këtë

Vendim

- I. Themelohet Grupi Punues për përgaditjen e KASH-it të Kuvendit të Kosovës 2018-2020, në bashkëpunim me Administratën, me këtë përberje: Fikrim Damka- kryesues, Sali Morina dhe Labinota Demi-Murtezi.
- II. Grupi Punues për punën e vet raporton në Komision.

Besa Gaxherri - shprehu shqetësimin rreth incidentit që ka ndodhur gjatë kthimit nga Shqipëria dhe e konsiderojë si diçka mjaftë serioze për të cilën duhet të sqarohet rasti dhe të ketë përgjegjësi. Përmes mediave jam informuar se dikush nga zyra e sekretarit ka thënë se kjo çështje duhet diskutuar në mënyrë interne e jo në seancë. Zoti sekretar është e rëndësishme të dihet me të vërtetë ai zyrtar që e ka thënë këtë dhe a është marrë ndonjë masë ndaj atij? Po ashtu duhet ditur a janë bërë ekspertizat e gomave të kombi busit për ti ditur shkaqet, si qendron kualiteti i tyre dhe kush është përgjegjës pasi që ne kemi qenë dhjetë veta në atë makinë dhe jeta ka qenë në rrezik.

Safete Hadërgjonaj - paisjet e gomave të makinave të Kuvendit duhet të jenë të kualitetit të lartë sepse është rrezikuar jeta e deputetëve dhe stafit të këtij Komisioni, andaj duhet pasur kujdes që të mos blihen goma gjithkund dhe të qfarëdo kualiteti.

Shukri Buja – veturat në të cilat udhëtojnë deputetët duhet me qenë normale dhe paisjet sikurse është rasti i gomave, duhet të jenë të kualitetit dhe standardeve të mira.

Mbledhja përfundoi në ora 11:26

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani